

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**UDHEZIM**

**Nr. 265 Datë 4. 12. 2002**

**PËR**  
**SHPENZIMET PROCEDURALE**

***Me synim,***

- llogaritjen dhe dokumentimin e shpenzimeve procedurale penale, që parapaguhen nga shteti, në fazën e hetimeve paraprake, si dhe;
- garantimin e pagimit të këtyre shpenzimeve proceduriale si detyrim ndaj shtetit.

***Mbështetur,*** në nenin 8 pika 2 e ligjit Nr, 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" dhe nenet 485-487 e vijues të K. Pr. Penale,

**U D H Ë Z O J:**

1. Në fazën e hetimeve paraprake, **prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, për çdo procedim penal, të llogarisin dhe dokumentojnë, të gjitha shpenzimet proceduriale që parapaguhen nga shteti,** neni 485/1 e 2 i K. Pr. Penale.
  - 1.1. Në **shpenzimet për këqyrjet** të përfshihen; shpenzimet e dokumentuara se janë kryer për këqyrjet e vendeve, përfshi vendin e ngjarjes, këqyrjet e përsoneve, sendeve dhe kufomave.
  - 1.2. Në **shpenzimet për eksperimentet** të përfshihen: shpenzimet e dokumentuara se janë kryer për eksperimentet Hdhur me verifikimin e mundësisë së të parit, dëgjimit ose kryerjes së disa veprimeve të caktuara, siç mund të jene verifikimi i mekanizmit të kryerjes së veprës penale në vendin e ngjarjes, etj.
  - 1.3. Në **shpenzimet për ekspertimet** të përfshihen:
    - 1.3.1 shpenzimet e llogaritura sipas llojit të **ekspertimit kriminalistik që është kryer, mbështetur në tarifën e miratuara me urdhrin Nr. 3644 datë 7. 12. 2001 të Ministrisë së Rendit Publik;**
      - Bashkëlidhur shkresa e Institutit të Policisë Shkencore Nr. 555 datë 9. 10. 2002 me tarifën e ekspertimeve kriminalistike.

- 1.3.2 shpenzimet e llogaritura sipas llojit të **shërbimit mjeko-ligjor** që është kryer, mbështetur në tabelën e tarifave të Shërbimit Qëndror Mjeko-Ligjor, miratuar me shkresën e Ministrisë Financave Nr. 1779/1 datë 21. 05. 1999;
- Bashkëlidhur shkresa e Ministrit të Drejtësisë Nr. 3375 datë 16. 09. 2002 me tabelën e tarifave të shërbimeve mjeko-ligjore.
- 1.3.3 shpenzimet e llogaritura sipas llojit të **espertimeve kontabël, autoteknik ose tloje të tjera, me tarifa orare të parcaktuara në shkresën e Ministrit të Financave Nr. 7469 datë 13. 12. 2001**, bashkëlidhur;
- 1.4 Në **shpenzimet për njoftimet** te përfshihen: shpenzimet e dokumentuara që janë kryer për njoftimet e bëra deklaruesve, të dëmtuarve dhe të pandehurve, nga ftuesi ose nëpërmjet shërbimit postar, me telefon, telegraf ose faks ose nëpërmjet shpalljes publike, për njoftimin e të pandehurit jashtë shtetit, etj, nenet 132, 133, 134, 142/1 e vijues të K. Pr. Penale.
- 1.5 Në **shpenzimet për mbrojtësit e caktuar kryesisht** të përfshihen: shpenzimet e dokumentuara që janë kryer për mbrojtësit e caktuar kryesishtë, sipas tarifave të përcaktuara në Rregulloren e Ministrit të Drejtësisë Nr. 2 datë 21. 03. 1996 "Për caktimin e tarifave të" shperblimit tavan për ndihmën juridike që japin avokatët", bashkëlidhur.
- 1.6 Në **shpenzimet e tjera që janë dokumentuar rregullisht**, mund të përfshihen:
- 1.6.1 **shpenzime sipas tarifave në fuqi për përkthimet, të llogaritura me tarifatat tavan, në analogji me tarifatat e përkthimeve për çdo fletë tipografike, të përcaktuara në nenin 1 paragrafi i tretë, pika Vllly e vendimin të Keshillit të Ministrave Nr. 550 date 11. 12. 1992**, bashkëlidhur;
- 1.6.2 shpenzimet e bëra **për aktet që janë deklaruar të pavlefshme nga gjykata** kur ka urdhëruar përsëritjen e tyre, neni 131 i K. Pr. Penale.
- 1.7 **Tarifatat orarë tavan** të përcaktuara me aktet nënligjore në fuqi, gjithmonë, **duhet të negocohen dhe dokumentohen me një marrëveshje të mëparëshme** ndërmjet prokurorit të çështjes dhe/ose drejtuesit të Prokurorisë me specialistët përkatës, **duke synuar për uljen e tarifës orare në vartësi me volumin dhe orët e punës së tyre.**

2. **Pagimi i shpenzimeve** procedurale dhe i shpërblimeve që u takojnë ekspertëve, përkthyesve, deklaruësve, etj, **duhet të bëhet nga fondi i caktuar në llogarinë përkatëse, me urdhër të drejtuesit të Prokurorisë, të kundërfirmuar nga prokurori i çështjes**, neni 182/2 e vijues të K. Pr. Penale, menjëherë pasi të jetë kryer veprimi dhe/ose depozituar në prokurori akti përkatës procedural penal.
3. **Shpenzimet procedurale**, të kryera në fazën e hetimeve paraprake, sipas zërave dhe llojeve në zbatim të këtij udhëzimi, para përfundimit të hetimeve, **përshkruhen në një akt përmbledhës, të emërtuar "Procesverbal për shpenzimet procedurale në hetimet paraprake"**, duke u mbështetur në nenet 115/1, 116, 485/2 e vijues të K. Pr. Penale.
4. **Prokurorët** të vlerësojnë kushtet dhe në mbështetje të nenit 270 të K. Pr. Penale, **të kërkojnë në gjykatë vendosjen e sekuestros konservative të pasurisë**, së të pandehurit dhe/ose të paditurit civil në procesin penal, **për të garantuar, që në fazën e hetimeve paraprake, pagimin e shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti.**
5. **Në fashikullin e gjykimit**, krahas akteve të tjera, **te' vendoset edhe origjinali i "Procesverbalit për shpenzimet procedurale në hetimet paraprake", bashkelidhur urdherat e shpërblimit, faturat ose dokumenta të tjera shoqëruese të tij.**
6. Në **përfundim të shqyrtimit gjyqësor, prokurori në konkluzionet përfundimtare**, krahas kërkesave për deklarimin e fajësisë së të pandehurit dhe caktimit ndaj tij të llojit e masës së dënimit, **duhet t'i parashtrijë gjykatës edhe kërkesën për detyrimin e të pandehurit/pandehurve dhe/ose të paditurit civil apo ankuesit, për të paguar shumën e shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti**, nenet 378, 485/3, 393, 397, 398 e vijues të K. Pr. Penale.
7. **Me marrjen e vendimit gjyqësor penal formë të prerë, prokurori i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale, krahas nxjerrjes së urdhërit për ekzekutimin e dënimit, duhet t'i kërkojë zyr'ës së përmbartimit ekzekutimin e detyrimit për shpenzimet procedurale të vendosura nga gjykata, neni 463/1 e 486/1 të K. Pr. Penale.**
8. Shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti **të raportohen**, për çdo procedim, sipas veprave dhe në total, **në kolonën përkatëse të statistikës 3, 6 e 9** mujore dhe vjetore.

9. Me këtë **udhëzim të njihen prokurorët e të gjithë niveleve të Prokurorive dhe oficerët e policisë gjyqësore.**
10. Per të **ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive të të gjitha niveleve dhe të strukturës së kësaj zyre.**
11. **Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje disiplinore,** neni 32 gërma "b" e ligjit "Për organizimin dhe funksionin e Prokurorisë në R. Sh".
12. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM  
THEODHORI SOLLAKU**